



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

**RREGULLORE (ZKM) NR. 21/2024 PËR ORGANIZIMIN E BRENDSHËM DHE
SISTEMATIZIMIN E VENDEVE TË PUNËS TË AGJENCISË PËR PRONËSI
INDUSTRIALE¹**

¹ Rregullorja (ZKM) Nr. 21/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Agjencisë për Pronësi Industriale, është miratuar nga Kryeministri me Vendimin Nr. 190/2024, të datës 20.11.2024

Kryeministri i Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 94 (paragrafi 3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 28 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura të Republikës së Kosovës, nenit 9, paragrafi 1 të Rregullores (QRK) Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe nenit 9 paragrafi 7 të Rregullores (QRK) Nr. 01/2020 për Standardet e Organizimit të Brendshëm, Sistematizimin e Vendeve të Punës dhe Bashkëpunimin në Institucionet e Administratës Shtetërore dhe Agjencitë e Pavarura,

Miraton:

RREGULLORE NR. 21/2024 PËR ORGANIZIMIN E BRENDSHËM DHE SISTEMATIZIMIN E VENDEVE TË PUNËS TË AGJENCISË PËR PRONËSI INDUSTRIALE

KAPITULLI I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim përcaktimin e organizimit të brendshëm të Agjencisë për Pronësi Industriale, në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (tutje “Agjencia”).

Neni 2 Fushëveprimi

Kjo rregullore zbatohet për Agjencinë për Pronësi Industriale, kompetencat e përgjithshme dhe shkalla e pavarësisë së Agjencisë përcaktohen me Ligjin përkatës për Patentat, si dhe legjisllacionin përkatës në fuqi.

KAPITULLI II ORGANIZIMI I BRENDSHËM I AGJENCISË

Neni 3 Misioni i Agjencisë

Agjencia për Pronësi Industriale është organ qendror administrativ i Ministrisë Industriale, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë e themeluar me ligj, dhe është përgjegjës për mbrojtjen ligjore të shpikjes, markës tregtare, dizajnit industrial, emërtimit të origjinës, treguesve gjeografik dhe topografive të qarqeve të integruara, si dhe çështjet e tjera që dalin nga marrëveshjet ndërkombëtare nënshkruese e të cilave është Republika e Kosovës.

Neni 4
Struktura Organizative e Agjencisë për Pronësisë Industriale

1. Struktura organizative e Agjencisë është si vijon:

1.1. Drejtori Ekzekutiv;

1.2. Divizionet.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorit Ekzekutiv përcaktohen me Ligjin përkatës për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, dhe Ligjin përkatës për Patenta.

3. Detyrat dhe përgjegjësitë e nëpunësit civil të Zyrës së Drejtorit Ekzekutiv, përcaktohen me Ligjin përkatës për Zyrtarët Publikë.

4.. Numri i të punësuarve në Agjencinë për Pronësi Industriale është njëzet e pesë (25).

Neni 5
Zyra e Drejtorit Ekzekutiv

1. Zyra e Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë për Pronësi Industriale përbëhet nga:

1.1. Drejtori Ekzekutiv;

1.2. Një (1) Asistent Administrativ; .

2. Numri i të punësuarve në Zyrën e Drejtorit Ekzekutiv është dy (2).

Neni 6
Divizionet e Agjencisë për Pronësi Industriale

1. Agjencia përbëhet nga këto divizione:

1.1. Divizioni për Patenta;

1.2. Divizioni për Marka Tregtare, Dizajn Industrial dhe Tregues Gjeografikë;

1.3. Divizioni për Çështje Administrative të pronësisë industriale;

1.4. Divizioni për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Promovim të pronësisë industriale.

Neni 7

Divizioni i Patentave

1. Misioni i Divizionit të Patentave është mbrojtja ligjore e patentave, topografive të qarqeve të gjysmëpërçuesve, përditësimin e legjislacionit për të mbështetur inovatorët dhe industrinë. Ky Divizion ka mision të angazhohet për të mirëmbajtur regjistrat dhe bazat e të dhënave të patentave me qëllim që të sigurojmë qasje të lehtë dhe të saktë në informacion, si dhe për të promovuar dhe mbrojtur inovacionet e mbështetura nga patentat.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit të Patentave janë:

2.1. Shqyrton kërkesat për njohje të patentës deri në vendimin përfundimtar sipas legjislacionit në fuqi;

2.2. Lëshon njoftime, vendime dhe shkresat e tjera sipas legjislacionit në fuqi për patentat;

2.3. Siguron mbrojtjen e topografive të qarqeve të gjysmëpërçuesve;

2.4. Propozon, harton dhe siguron zbatimin e legjislacionit nga fusha e patentave;

2.5. Mirëmban regjistrin e kërkesave për njohje të patentave dhe regjistrin e patentave;

2.6. Përgatit certifikatat për të drejtën e përparësisë dhe certifikatat për regjistrimin e patentave;

2.7. Nxjerrë vendim për regjistrimin e Certifikatave të Mbrojtjes Shtesë të Patentave;

2.8. Lëshon informacione për regjistrat e patentave;

2.9. Mirëmban bazën e të dhënave të patentave;

2.10. Përgatit materialet promovuese për mbrojtjen e produkteve me patentë.

3. Udhëheqësi i Divizionit për Patenta raporton tek Drejtori i Agjencisë.

4. Numri i të punësuarve në Divizionin e Patentave është tre (3).

Neni 8

Divizioni për Marka Tregtare, Dizajn Industriale dhe Tregues Gjeografikë

1. Misioni i Divizionit për Marka Tregtare, Dizajn Industrial dhe Tregues Gjeografikë është mbrojtja ligjore e markave tregtare, dizajneve industriale dhe treguesve gjeografikë. Ky Divizion ka mision regjistrimin dhe mirëmbajtjen e regjistrave dhe bazën e të dhënave të këtyre objekteve të pronësisë industriale me qëllim që të sigurojmë qasje të lehtë dhe të saktë në informacion, si dhe për të promovuar mbrojtjen e markave tregtare, dizajneve industriale dhe treguesve gjeografikë.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Marka Tregtare, Dizajn Industrial dhe Tregues Gjeografikë janë:

2.1 shqyrton dhe trajton kërkesat në lidhje me regjistrimin, ndryshimin në regjistër, dhe vazhdimin e markave tregtare, dizajnëve industriale, treguesve gjeografikë, dhe emërtimeve të origjinës, duke përfshirë të gjitha procedurat që variojnë nga aplikimi fillestar deri te vendimi përfundimtar, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2.2. mirëmban regjistrin e aplikimeve dhe regjistrat e regjistrimeve të markave tregtare, dizajnit industrial dhe treguesve gjeografik;

2.3. përgatit certifikatat e regjistrimit, certifikatat për të drejtën e përparësisë, dokumentacionin relevant sipas kërkesave për markë tregtare, dizajn industrial dhe tregues gjeografikë;

2.4. mirëmban bazën e të dhënave për marka tregtare, dizajn industrial dhe tregues gjeografikë;

2.5. propozon, harton dhe siguron zbatimin e legjislacionit nga fusha e markave tregtare, dizajn industrial dhe treguesve gjeografik;

2.6. lëshon informacione dhe ekstrakte regjistri për markë tregtare, dizajn industrial dhe tregues gjeografikë;

2.7. përgatit materialet dhe bën promovimin e mbrojtjes së të drejtave me markë tregtare, dizajn industrial dhe tregues gjeografikë.

3. Udhëheqësi i Divizionit për Marka Tregtare, Dizajn Industriale dhe Tregues Gjeografikë i raporton Drejtorit të Agjencisë.

4. Numri i të punësuarve në Divizionin për Marka Tregtare, Dizajn Industriale dhe Tregues Gjeografikë është tetë (8).

Neni 9

Divizioni për Çështje Administrative të pronësisë industriale

1. Misioni i Divizionit për Çështje Administrative të pronësisë industriale është ofrimi i mbështetjes profesionale për pronësinë industriale për të garantuar zbatimin e ligjeve të pronësisë industriale, administrimin e pranimit të aplikacioneve si dhe organizimin e licencimit të përfaqësuesve të autorizuar në fushën e pronësisë industriale.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Çështje Administrative të pronësisë industriale janë:

2.1. ofron mbështetje administrative profesionale dhe ligjore për pronësinë industriale;

2.2. propozon, harton dhe publikon Buletinin Zyrtar të Agjencisë për Pronësi Industriale;

2.3. është përgjegjës për administrimin dhe mirëmbajtjen e zyrës së pranimit të kërkesave për regjistrimin e objekteve të pronës industriale në Agjenci;

- 2.4. është përgjegjës për administrimin e pranimit të aplikimeve për objektet e pronësisë industriale
- 2.5. është përgjegjëse për shqyrtimin e kërkesave për kundërshtimin e markave tregtare, shfuqizimeve dhe revokimeve të markave tregtare dhe kërkesat për pavlefshmëri dhe ankesa e tjera për objektet e pronësisë industriale sipas legjislacionit në fuqi;
- 2.6 është përgjegjës për administrimin procedurës së ankesave kundër vendimeve të Agjencisë;
- 2.7 përgatit dokumentacionin dhe informacionet për komisionin e Ankesave kundër vendimeve të Agjencisë;
- 2.8. monitoron sistemin IPAS (Sistemi i Automatizimit të Pronësisë Industriale) dhe në bashkëpunim me Ministrinë propozon politika për avancimin e teknologjisë informative;
- 2.9 ofron informacione për objektet e pronësisë industriale, mirëmban ueb faqen dhe profilet e Agjencisë në mediat sociale;
- 2.10 në bashkëpunim me Ministrinë përgatit planin e shpenzimeve vjetore të buxhetit të Agjencisë dhe propozon trajnimet për zyrtarët;
- 2.11 organizon licencimin e përfaqësuesve të autorizuar dhe mirëmban regjistrin e tyre;
- 2.12 nxjerr statistikatat për objektet e pronësisë industriale;
- 2.13 përgatit statistikatat për kërkesat hyrëse dhe dalëse për objektet e pronësisë industriale konkretisht për marka tregtare, patenta, dizajnë industriale, tregues gjeografik dhe të dhënat e tjera statistikore për efikasitetin e zyrtarëve të Agjencisë;
3. Udhëheqësi i Divizionit të Çështjeve Administrative të pronësisë industriale i raporton Drejtorit të Ekzekutiv të Agjencisë së Pronësisë Industriale.
4. Numri i të punësuarve në Çështje Administrative të pronësisë industriale është tetë (8).

Neni 10

Divizioni i Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe Promovimit të pronësisë industriale

1. Misioni i Divizionit për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Promovim të pronësisë industriale është të koordinojë dhe të promovojë efikasitetin dhe integritetin e sistemit të pronësisë përmes koordinimit të bashkëpunimit me organizatat ndërkombëtare dhe institucionet vendore, si dhe përmes propozimit dhe zbatimit të marrëveshjeve ndërkombëtare në fushën e pronësisë industriale. Nëpërmjet aktiviteteve promovuese dhe trajnuese, Divizioni promovon ndërgjegjësimin e publikut dhe të grupimeve të interesit për rëndësinë e mbrojtjes së pronësisë industriale.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Promovim të pronësisë industriale janë:

2.1. koordinon bashkëpunimin në mes Agjencisë, zyrave homologe dhe organizatave ndërkombëtare ku Republika e Kosovës është anëtare;

2.2. propozon ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare në fushën e pronësisë industriale dhe siguron përmbushjen e obligimeve në zbatimin e tyre;

2.3. shërben si burim kontakti midis Agjencisë dhe organizatave ndërkombëtare të pronësisë industriale si WIPO, EPO, EUIPO, si dhe zyrave kombëtare të pronësisë industriale në vende të tjera, sipas marrëveshjeve ndërkombëtare në të cilat Republika e Kosovës është pjesë;

2.4. shërben si pikë kontakti mes Agjencisë dhe institucioneve të përfshira në sistemin e mbrojtjes së pronësisë industriale, si dhe të gjitha institucionet apo organizatat e tjera në vend;

2.5. shërben si pikë kontakti me projektet e angazhuara për asistencë teknike të Agjencisë;

2.6. harton planet vjetore të aktiviteteve të promovimit dhe promovon mbrojtjen e pronësisë industriale;

2.7. organizon aktivitetet promovuese dhe trajnuese në fushën e pronësisë industriale;

2.8. harton materialet për promovimin e pronësisë industriale dhe i shpërndanë tek grupet e interesit;

2.9. promovon rëndësinë e mbrojtjes së pronësisë industriale, me qëllimi ndërgjegjësimin e publikut dhe grupeve të interesit për rëndësinë e mbrojtjes së produkteve me pronësi industrial;

2.10. përgatit programe trajnimi për institucionet, universitetet, shkollat e mesme dhe për të gjitha grupet e tjera të përcaktuara për trajnime në fushën e pronësisë industriale sipas mandatit ligjor të Agjencisë

2.11. harton kurrikulat e trajnimit të cilat specifikohen për nevojat e organizimit të trajnimeve;

2.12. harton dhe koordinon projekte që nxisin zhvillimin e sistemit të pronësisë industriale në vend;

3. Udhëheqësi i Divizionit të Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe Promovimit të pronësisë industriale i raporton Drejtorit të Ekzekutiv të Agjencisë për Pronësi Industriale.

4. Numri i të punësuarve në Divizionin e Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe Promovimit të pronësisë industriale është tre (3).

KAPITULLI III

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE DHE SHFUQIZUESE

Neni 11

Dispozitat përfundimtare

1. Rritja apo zvogëlimi i numrit të personelit në pajtim me ligjin vjetor të buxhetit nuk krijon nevojë për plotësim ndryshimin e kësaj Rregulloreje, përpos në rastet kur krijohen dhe/apo shuhen strukturat organizative.
2. Në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, dispozitat e ligjit vjetor të buxhetit janë pjesë përbërëse e kësaj Rregulloreje.

Neni 12

Shërbimet e Përgjithshme

Për kryerjen e shërbimeve të përgjithshme për Agjencinë për Pronësi Industriale obligohet Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 13

Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore shfuqizohen nenet 72 deri 78 të Rregullores nr. 29/2012 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

Neni 14

Hyrja në Fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës

Albin Kurti

Kryeministër i Republikës së Kosovës

20/11/2024

Shtojca 1

Organogrami i Agjencisë për Pronësi Industriale				
Pozicioni/Struktura	Klasa	Grupi (i përgjithshëm ose i veçantë)	Nr.	Tot.
1. Zyra e Drejtorit Ekzekutiv				2
Drejtori Ekzekutiv	Drejtues i Lartë		1	
Asistent Administrativ	Profesional 3	64 Gr. i Administrimit të përgjithshëm	1	
2. Divizioni për Patenta				3
Udhëheqësi i Divizionit	Drejtues i Ulët		1	
Zyrtar i lartë për Ekzaminim të Patentave	Specialist	16. Gr. Grupi i përgjithshëm i inxhinierisë	1	
Zyrtar i lartë për Ekzaminim të Patentave dhe Topografive të Gjysmëpërçuesve	Specialist	16. Gr. Grupi i përgjithshëm i inxhinierisë	1	
3. Divizioni për Marka Tregtare, Dizajn Industrial dhe Tregues Gjeografikë				9
Udhëheqësi i Divizionit	Drejtues i Ulët		1	
Zyrtar i lartë për Ekzaminim të Markave Tregtare	Profesional 1	12 Gr. i shkencave shoqërore	6	
Zyrtar i lartë për ekzaminim të Dizajnit Industrial	Profesional 1	12 Gr. i shkencave shoqërore	1	
Zyrtar i lartë për ekzaminim të Treguesve	Profesional 1	12 Gr. i shkencave shoqërore	1	

Gjeografik dhe Emërtimeve të Origjinës				
4. Divizioni për Çështje Administrative të pronësisë industriale	8			
Udhëheqësi i Divizionit	Drejtues i Ulët		1	
Zyrtar i lartë për kundërshtime të markave tregtare	Profesional 1	1 Gr. Grupi ligjor	2	
Zyrtar i lartë për shfuqizime, revokime dhe ankesa të pronësisë industriale	Profesional 1	1 Gr. Grupi ligjor	1	
Zyrtar për çështje administrative të pronësisë industriale	Profesional 2	63 Gr. i Administrimit të përgjithshëm	2	
Zyrtar për indeksim të dokumentacionit të pronësisë industriale	Profesional 2	7 Gr. i Arkiv - dokumentacionit	2	
5. Divizioni për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Promovim të pronësisë industriale	3			
Udhëheqësi i Divizioni	Drejtues i Ulët		1	
Zyrtar i lartë për promovimin e pronësisë industriale	Profesional 1	12 Gr. i shkencave shoqërore	1	
Zyrtar i lartë për marrëdhënie ndërkombëtare dhe promovim të pronësisë industriale	Profesional 1	12 Gr. i shkencave shoqërore	1	
			Tot.	25

Agjencia për Pronësi Industriale

